



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Akademia e Drejtësisë - Akademija Pravde - Academy of Justice

Buletini informativ

- * Aktivitetet e përgjithshme
- * Aktivitetet nga Programi I Trajnimit Fillestar (PTF)
- * Aktivitetet nga Programi i Trajnimit të Vazhdueshëm (PTV)

Janar 2022

Aktivitetet e përgjithshme

Punëtori për rishikimin e Programit të trajnimit Fillestar për gjeneratën e IX të prokurorëve 2022-2023



Më 20 dhe 21 janar 2022, Akademia e Drejtësisë ka realizuar Punëtorinë për rishikimin/hartimin e Programit të Trajnimit Fillestar për gjeneratën e nëntë të prokurorëve të sapo emëruar 2022/2023.

Qëllimi i kësaj punëtorie ishte rishikimi dhe hartimi i përmbajtës së moduleve trajnuese, sesioneve trajnuese dhe plotësimi me nën module të reja të Programit të Trajnimit Fillestar për prokurorët që do të dekretohen së shpejti dhe që për Akademinë e Drejtësisë përbëjnë gjeneratën e IX të prokurorëve në trajnimin fillestar.

Në kuadër të kësaj punëtorie është përcaktuar

metodologjia nga trajnuesit e cila synohet të zbatohet gjatë realizimit të trajnimeve fillestare, gjithashtu edhe ndjekja e trajnimit teorik paralelisht me trajnimin praktik që nënkupton dy ditë trajnimi teorik dhe 3 ditë trajnimi praktik. Po ashtu u përcaktua që gjatë trajnimit teorik të merren parasysh rastet praktike dhe diskutimi në formë të bashkëbisedimit.

Gjatë punëtorisë pjesëmarrësit në cilësi të trajnuesve përveç rishikimit të programit të trajnimit fillestar dhe editimit të nën moduleve dhanë edhe propozimet e tyre rreth vlerësimit të prokurorëve për gjeneratën e (nëntë) duke u bazuar në ndryshimin e rregullores së Trajnimit Fillestar duke pasur parasysh që për prokurorët të trajtohet vetëm lëmia penale. Trajnuesit punuan të ndarë në grupe sipas fushave adekuate në përmbajtjen e nën moduleve.

Pjesëmarrës të kësaj punëtorie ishin: Prokuror nga Prokuroria Speciale e Kosovës, prokuror nga niveli themelor si dhe stafi i Akademisë së Drejtësisë.



Aktivitetet nga Programi i Trajnimeve Fillestare

Gjatë muajit janar gjyqtarët e sapo emëruar të gjeneratës së VIII kanë vazhduar realizimin e trajnimit praktik në gjykatat përkatëse ku janë të emëruar. Po ashtu krahas trajnimit praktik në gjykatat përkatëse për 24 gjyqtarët e kësaj

gjenerate në datat 12, 21 dhe 24 janar është realizuar vizitë në institucione jo gjyqësore. Në vijim detajet sa i përket vizitave dhe institucioneve:

Vizita në institucionin “ Avokati i Popullit”

Më 12 janar 2022, është realizuar vizita në “Institucionin e Avokatit të Popullit”. Në fjalën hyrëse avokati i popullit z. Naim Qelaj fillimisht ju uroi mirëseardhjen gjyqtarëve të sapo emëruar duke e cilësuar të duhur qëllimin



e kësaj vizite dhe bashkëpunimin me Akademinë e Drejtësisë, për të vazhduar më pas diskutimin lidhur me rolin, mandatin dhe sfidat e këtij institucioni në sigurimin dhe bashkëpunimin e ndërsjellët në fushën e drejtësisë.

Programi kishte qëllim që gjyqtarëve t’iu ofrojë njohuri lidhur me procedurat e hetimit të ankesave në pretendimet e qytetarëve për shkelje të të drejtave të njeriut, e deri te përgatitja e rekomandimeve për rastet e tilla.

Me rastin e kësaj vizite gjyqtarët patën mundësinë të njihen me mekanizmat kombëtar për parandalim të torturës, raportet me rekomandimet të dala nga trajtimi i ankesave dhe kërkesave dhe vizitave të rregullta dhe pa paralajmërim në të gjitha vendet ku mbahen personat e privuar nga liria. Po ashtu gjyqtarët u njoftuan edhe me pranimin dhe shqyrtimin e ankesave në IAP, relacioni në mes IAP dhe gjyqësorit, dhe procedurat e pranimin të ankesave dhe shqyrtimi i tyre nëse ankesat, kërkesat apo njoftimet e pranuar janë brenda kompetencave dhe përgjegjësi të IAP-së.



Vizita në “Gjykatën Kushtetuese”

Më 21 janar 2022, është realizuar vizita në “Gjykatën Kushtetuese”.



Ky program ka për qëllim t’iu ofroj gjyqtarëve të sapoemëruar njohuri lidhur me rolin e Gjykatës Kushtetuese si dhe juridiksionin e kësaj gjykate dhe palët e autorizuar.

Në fjalën hyrëse gjyqtari z. Nexhmi Rexhepi i’u uroi mirëseardhjen gjyqtarëve të sapo emëruar

duke e cilësuar të duhur qëllimin e kësaj vizite dhe bashkëpunimin me Akademinë e Drejtësisë. Në vazhdim vizita u fokusua në diskutimin lidhur me rolin, mandatin dhe sfidat e këtij institucioni në sigurimin dhe bashkëpunimin e ndërsjellët në fushën e drejtësisë. Gjithashtu u trajtua kontrolli incidental, parimi i subsidiaritetit dhe kërkesat e kushtetutës për standardet e interpretimit të të drejtave dhe lirive themelore kushtetuese.

Po ashtu gjyqtaret u njoftuan edhe me bashkëpunimin e Gjykatës Kushtetuese me mekanizmat ndërkombëtar.

Vizita në “Institutin e Mjekësisë Ligjore ”

Më 24 janar 2022, është realizuar vizitë në “Institutin e Mjekësisë Ligjore”.

Musa Gashi, përfaqësues nga ky institucion mirëpriti gjyqtarët duke e vlerësuar lartë qëllimin e kësaj vizite e më pas i’u foli atyre për ekspertizën mjeko ligjore në shërbim të organeve të drejtësisë, objektet e ekspertimit mjeko-ligjor, investigimi mjeko ligjor në shërbim të ligjit, metodat tekniko shkencore të investigimit si dhe arsyetimi dhe gjykimi mjeko ligjor. Gjithashtu në kuadër të kësaj vizite u trajtua ekspertimi i kufomave, personave të gjallë, ekspertimi i provave materiale dhe ekspertimi i materialeve të çështjes.

Po ashtu gjyqtaret patën mundësin qe nga afër të



shohin laboratorin e toksikologjisë dhe sallat ku kryhet autopsia.

Aktivitetet nga Programi i Trajnimeve të Vazhdueshme

Fuqizimi i kapaciteteve të prokurorëve-Unifikimi i praktikave të prokurorisë

Më 28 Janar 2022 Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit për Trajnimeve të Vazhdueshme në bashkëpunim me EULEX, ka realizuar punëtorinë me temë “Fuqizimi i kapaciteteve të prokurorëve -Unifikimi i praktikave të prokurorisë”.



Qëllimi i kësaj punëtorie ishte diskutimi i çështjeve problematike të cilat shfaqen në praktikë veçanërisht në rastet kur fëmijët janë viktimë e krimit apo dëshmitarë dhe adresimi i tyre përmes analizimit dhe sqarimit të dispozitave ligjore relevante.

Gjatë punëtorisë në veçanti janë diskutuar veq e veq sfidat dhe problemet në praktikë sa i përket mënyrës së vendosjes për rastet kur e dëmtuara është e mitur tek veprat penale të listuar në nenin 108 të KDM-së, për procedurat

alternative, për masat edukative dhe masat e diversitetit, dhe disa çështje tjera që lidheshin më marrjen në pyetje të të miturve dhe viktimave nga ana e policisë dhe prokurorisë. Për të gjitha këto diskutime është bërë përpjekje për shmangien e situatave ku për të njëjtat çështje ka qëndrime të ndryshme në prokuroritë e ndryshme të Kosovës.

Punëtorja është fokusuar në trajtimin teorik dhe praktik të Unifikimit të praktikave të prokurorisë – Departamentit për të mitur, në zbatimin e Kodit të Drejtësisë për të Mitur, duke i kushtuar kujdesë dispozitave të Kodit të Drejtësisë për të Mitur, Kodit Penal dhe Kodit të procedurës penale.

Metodologjia e punëtorisë ishte diskutim interaktiv, prezantim i çështjeve përmes rasteve, diskutim për rastet dhe përmbledhje e konkluzave për çështjen e diskutuar.

Përfitues të kësaj punëtorie ishin 11 prokurorë kryesisht nga niveli themelor, 5 prej tyre ishin nga Departamenti për të Mitur si dhe 6 nga Departamenti i Përgjithshëm

Akademia e Drejtësisë

<https://ad.rks-gov.net>

infoad@rks-gov.net

Rr. "Muharrem Fejza"-Prishtinë

Tel:+383 38 200 18 660